


RAPORTI I DËGJIMEVE BUXHETORE PËR PLANIFIKIMIN E PROJEKT-BUXHETIT PËR VITET 2027-2029



**KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN**





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË:		09.09.2026	
PRIMIEN DANA:			
NJËSIA JEDINICA 01-	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE 052/01-	NR. LËNDËS BR. PREDMETA 47189	SHTOJCA PRILOG



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e kryetarit të komunës

Datë:	09.09.2026
Për:	Z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje:	Z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Z. Mehreme Goliqi – Nënkyetare e Komunës Z. Latif Ramadani – Drejtor për Buxhet dhe Financa
Nga:	Z. Ferdian Shala – Zyrtar për Informim
Lënda:	Raporti i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e projekt-buxhetit për vitet 2027-2029

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 paragrafi 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 qershor 2008; neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr. 110-78095, të datës 24.12.2021; Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2020 për Transparencën në Komuna, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Rregullores për Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, të datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimtë për Transparencë në Komunë, me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, përfaqësuesit e Komunës, konkretisht nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kanë mbajtur dëgjime publike me qytetarët e vendbanimeve të ndryshme të Lipjanit për planifikimin e buxhetit për vitet 2027–2029.

Përmbajtja

1. Vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit 2027-2029..	4
2. Ecuria e procesit	5
3. Dëgjimi Buxhetor me Anëtarët e Kuvendit Komunal dhe Komitetet tjera.....	6
4. Dëgjimi Buxhetor me gratë dhe shoqatat e grave.....	9
5. Dëgjimi Buxhetor me organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit.....	10
6. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Lipjanit dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave	11
7. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Gadimes	12
8. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Grackës së Vjetër – komunitetet jo shumicë	13
9. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Dobrajës së Madhe.....	14
10. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Shalës.....	15
11. Dëgjimi Buxhetor nga kuvendi me kuvendaret, anëtarët e KPF-së, komitetet tjera, OJQ-të, përfaqësueset e grupit të grave dhe kryetarët e këshillave të fshatrave	16
12. Konkluzionet.....	17



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIFIKIMIT TË
PROJEKT BUXHETIT 2027-2029**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2027-2029, në përbërje si vijon:

1. Latif Ramadani, Drejtor në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, Kryesues
2. Visar Kozhani, Zyrtar në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtar,
3. Alban Bytyqi, Zyrtar financiar në QKMF, anëtar,
4. Behar Aliu, Zyrtar në Drejtoratin për Administratë, anëtar dhe
5. Ferdian Shala, Zyrtar në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtar.

**Neni 2
Detyrat e Grupit Punues**

Grupi punues ka për detyrë hartimin e projekt planifikimit të buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2027-2029 si dhe organizimin e degjimeve buxhetore në Komunën e Lipjanit. Grupi punues bënë vlerësimin e kërkesave të pranuar nga qytetarët dhe vendos cilat kërkesa pranohen dhe cilat refuzohen. Grupi punues duhet të hartojë planin e punës dhe të caktoj orarin e mbajtjes së degjimeve buxhetore duke mbajtur procesverbal dhe duke hartuar raport të punës së kryer të gjitha detyrat e hartimit të planifikimit të buxhetit për vitin 2027-2029 dhe organizimin e degjimeve buxhetore do të bëjë konform dispozitave të parapara ligjore që janë në fuqi. Po ashtu në fund të hartojë raportin nga degjimet buxhetore për ta dërguar në Kuvendin e Komunës. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e degjimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjës për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

**Neni 3
Hryja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-22345
Lipjan, më 18.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



Ecunia e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin e Platformës së Konsultimeve Publike dhe koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, ka publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit njoftimin për orarin e mbajtjes së dëgjimeve publike. Njoftimi është publikuar edhe në faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit në Facebook shih linqet. ↓

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitet 2027–2029:<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Njoftim-lidhur-me-degjimet-buxhetore-per-planifikimin-e-buxhetit-per-vitet-2027%E2%80%932029.pdf>

<https://www.facebook.com/share/p/1E1LNrGbDy/>
<https://www.facebook.com/share/p/1HZCCyAPFC/>

Po ashtu, në faqen zyrtare të Komunës, në rubrikën për konsultimet publike, është publikuar edhe draft projekt-buxheti, përmes të cilit qytetarët kanë pasur mundësi të paraqesin komentet dhe sugjerimet e tyre lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027–2029.

Shih linkun ➡ <https://lipjan.rks-gov.net/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve publike është publikuar brenda afatit të përcaktuar ligjor, në përputhje me nenin 16 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Palët e interesuara janë njoftuar për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimeve publike. Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i shqyrtimeve publike ku ka qenë në diskutim publik projekt-buxheti për vitet 2027–2029.

Dëgjimi i parë publik për planifikimin e buxhetit është mbajtur me anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete dhe komitetet e tjera. Procesi ka vazhduar me organizimin e takimeve me grupe të veçanta, përfshirë gratë dhe shoqatat e grave, organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë dhe shoqatat e të rinjve, klubet sportive, si dhe fermerët e Komunës së Lipjanit. Ndërsa dëgjimet publike kanë vazhduar me banorët e qytetit të Lipjanit, kryetarët e këshillave të fshatrave dhe banorët e fshatit Gadime. Më pas, dëgjimet buxhetore janë zhvilluar edhe në fshatrat Grackë e Vjetër, me komunitetet jo-shumicë, Dobrajë e Madhe dhe Shalë.

Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Latif Ramadani, para të pranishmëve ka prezantuar projekt-buxhetin për vitet 2027–2029 dhe ka pranuar kërkesat e paraqitura gjatë këtyre takimeve. Ai ka inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë në dëgjimet publike dhe të paraqesin kërkesat dhe propozimet e tyre për planifikimin e buxhetit për vitet e ardhshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal z. Daut Azemi, ka organizuar dëgjime të veçanta buxhetore me anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësuese të grupit të grave dhe kryetarët e këshillave të fshatrave. Gjatë këtyre dëgjimeve është diskutuar për projekt-buxhetin e Komunës së Lipjanit për vitet 2027–2029.

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, me "Anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitet, si dhe Komitetet tjera".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027-2029	1. Rregullimi i rrethojës së parkut të fshatit Banullë? 2. Rregullimi i shkollës së vjetër në Banullë? 3. Mirëmbajtja e investimeve të bëra në territorin e komunës? 4. Pajisja e shkollave me inventarë ose pompa termike? 5. Vendosja e paneleve solare në shkolla? 6. Rregullimi i urës mbi lumin Sitnica në Hallaq i Vogël, Ruf i Ri dhe Ruf i Vjetër? 7. Pastrimi i lumit të fshatit? 8. Vendosja e trotuareve me ndriçim publik në disa rrugica të këtyre fshatrave? 9. Rikonstruktimi i rrugës Rubovc-Lipjan? 10. Zgjidhja e problemit të ujit të pijes në fshatrat ku ka probleme me uje te pijes? 11. Zgjidhja e problemit të ujit të pijes në Medvec, në lagjen ku banojnë komunitete jo shumicë?	1. Kërkesa është pranuar. Në Banullë është planifikuar ndërtimi i hapësirave publike gjatë viteve 2027-2028. 2. Kërkesa është pranuar. Në planifikimin buxhetor është paraparë renovimi i objekteve të vjetra shkollore në Banullë dhe Dobrajë. 3. Kërkesa është pranuar. Përmes kontratës së mirëmbajtjes do të mirëmbahen edhe terrenet sportive. 4. Kërkesa është pranuar. Në planifikimin buxhetor është paraparë investimi në shkolla, përfshirë tabelat dixhitale dhe inventarin. 5. Kërkesa është pranuar pjesërisht. Përmes kodit buxhetor të donatorëve do të shqyrtohet mundësia e pajisjes së shkollave me panele solare. 6. Kërkesa është pranuar. Në Hallaq të Vogël është planifikuar ndërtimi i urës për këmbësorë. 7. Kërkesa është pranuar. Përmes kontratës së mirëmbajtjes do të pastrohen edhe lumenjtë. 8. Kërkesa është pranuar. Në disa vendbanime janë planifikuar projekte për ndërtimin dhe rikonstruktimin e trotuareve, së bashku me ndriçimin publik. 9. Kërkesa është pranuar. Për rrugën Rubovc i Vogël-Kojnskë-Lipjan është planifikuar investim në buxhetin për vitet 2027-2029.	F M T 8 20 28	27.08.2026 Salla e Kuvendit Komunal Ora 14:00

		10. Kërkesa është pranuar. Në planifikimin buxhetor për vitet 2027–2029 është paraparë edhe investimi në ujësjellës në disa fshatra.		
		11. Kërkesa është pranuar, pasi që në fshatin Medvec do të bëhet rikonstruktimi i ujësjellësit.		



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Anëtarët e Kuvendit Komunal, Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitet, si dhe komitetet tjera".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, me "Gratë dhe shoqatat e grave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027-2029	- Kërkoj mbështetje për organizimin e panairove, ku gratë që merren me prodhimin e produkteve ushqimore dhe artizanale të kenë mundësi t'i shesin produktet e tyre? - Kërkoj ndarjen e subvencioneve për gratë që dëshirojnë të hapin një biznes të ri (start-up)?	- Kërkesa është pranuar. Varësisht nga kërkesat, Komuna e Lipjanit çdo vit mbështet organizimin e panairove që kanë për qëllim t'i ndihmojnë gratë që merren me bizneset e ushqimeve tradicionale, duke u krijuar mundësi për promovimin dhe shitjen e produkteve të tyre. - Kërkesa është pranuar. Komuna e Lipjanit, së bashku me donatorët, vazhdimisht ka përkrahur gratë që kanë paraqitur kërkesa për mbështetje në themelimin dhe zhvillimin e bizneseve start-up.	F M T 20 7 27	27.08.2026 Salla e Kuvendit Komunal Ora 15:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Gratë dhe shoqatat e grave".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, me "Organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027-2029	1. Rregullimi i ndriçimit të rrugëve në Hallaq të Madh? 2. Asfaltimi i rrugëve në Hallaq të Madh? 3. Ndryshimi i kriterëve për subvencionet në bujqësi? 4. Rritja e subvencioneve për sport? 5. Shpërndarja e subvencioneve me kohë dhe evitimi i vonësive në ekzekutimin e tyre?	1. Kërkesa është pranuar. Përmes kontratës për mirëmbajtje do të rregullohet ndriçimi publik në ato lokacione ku është i dëmtuar. 2. Kërkesa është pranuar. Në planifikimin buxhetor është paraparë asfaltimi i rrugicave në Hallaq të Madh. 3. Kërkesa është pranuar. Drejtoria për Bujqësi, në përputhje me rregulloren në fuqi, i përcakton kriteret për subvencionim. 4. Kërkesa është pranuar. Komuna e Lipjanit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, vazhdimisht ka rritur buxhetin për subvencionimin e sportit. 5. Kërkesa është pranuar, por kjo çështje nuk varet vetëm nga Komuna e Lipjanit, pasi varet edhe nga alokimi i mjeteve financiare nga niveli qendror.	F M T 3 9 12	27.08.2026 Salla e Kuvendit Komunal Ora 16:00

NA LIPJAN - MUNICIPALITY OF LIPJAN



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuar, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive dhe fermerët e Komunës së Lipjanit".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, me "Qytetarët e Lipjanit dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027-2029	- Të rikonstruktohet rruga "Kreshnik Vishësella", që lidh Ribar të Vogël me Ribar të Madh? - Kërkesa tjetër është pastrimi i parqeve publike në fshatin Ribar i Vogël?	- Kërkesa është pranuar, pasi që në planifikimin buxhetor është paraparë rikonstruktimi i rrugës kryesore në Ribar të Vogël. - Kërkesa është pranuar pjesërisht. Do të shqyrtohet mundësia që, përmes kontratës për mirëmbajtjen e parqeve, të planifikohet edhe mirëmbajtja e parqeve në fshatra.	F M T 0 6 6	27.08.2026 Salla e Kuvendit Komunal Ora 17:30



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Lipjanit dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, me "Qytetarët e Gadimes".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetareve	Komentet për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027-2029	1. Ndërtimi i një fushe sportive për Klubin e Futbollit të Gadimes? 2. Zgjerimi i dy urave? 3. Rikonstruktimi i rrugës Babushë–Gadime, përfshirë edhe trotuarin?	1. Kërkesa është pranuar. Për fushën e futbollit në Gadime është paraparë investim për vitet 2027–2028. 2. Kërkesa është pranuar. Në planifikim është paraparë ndërtimi i urave në Gadime. 3. Kërkesa është pranuar. Për rikonstruktimin e rrugës Babushë–Gadime e Ulët–Gadime e Epërme është planifikuar investim për vitet 2028–2029.	F M T 0 14 14	27.08.2026 Shkolla fillore "Zenel Hajdini", Gadime Ora 18:30



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Gadimes".

Organizimi i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit 2027-2029 ka vazhduar më datën 28.08.2026 me banorët e fshatrave Grackë e Vjetër (komuniteti jo shumicë), Dobrajë e Madhe dhe Shalë.

Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, gjatë takimeve ka bashkëbiseduar me banorët e këtyre lokaliteteve për planifikimin e buxhetit 2027-2029 dhe ka marrë në konsideratë kërkesat dhe prioritetet për të cilat qytetarët e këtyre fshatrave kanë më shumë nevojë, në mënyrë që të përfshihen në planifikimet buxhetore.

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, me "Qytetarët e Grackës së Vjetër"

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027-2029	- Asfaltimi dhe zgjerimi i rrugës kryesore në fshatin Grackë? - Vendosja dhe rregullimi i energjisë elektrike për ndriçimin publik në dy pjesët e fshatit, me nga pesë shtylla elektrike?	- Kërkesa është pranuar. Komuna e Lipjanit ka paraparë në projektbuxhetin e Komunës ndërtimin e rrugicave në Grackë të Vjetër. - Kërkesa është pranuar. Përmes kontratës për mirëmbajtje do të rregullohen ndriçuesit që janë të dëmtuar.	F M T 0 5 5	28.08.2026 Shkolla fillore në Grackë të Vjetër Ora 17:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Grackës së Vjetër".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, me "Qytetarët e Dobrajës së Madhe"

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027-2029	- Zgjerimi i rrugës që çon te varrezat në Dobrajë të Madhe? - Pastrimi i kanalizimit, pasi është bllokuar në disa vende?	- Kërkesa nuk është pranuar, për shkak të problemeve pronësore që paraqiten lidhur me zgjerimin e rrugës së varrezave. Megjithatë, do të shqyrtohet mundësia që kjo kërkesë të planifikohet për vitet e ardhshme. - Kërkesa është pranuar. Përmes kontratës së mirëmbajtjes do të intervenohet në kanalizimet e bllokuara.	F M T 0 6 6	28.08.2026 Shkolla fillore "Dy Dëshmorët" Dobrajë e Madhe Ora 18:30




Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup " Qytetarët e Dobrajës së Madhe ".

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, me "Qytetarët e Shalës"

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027-2029	1. Zgjerimi i rrugës kryesore, së bashku me trotuarin dhe ndriçimin publik? 2. Ndërtimi i një shëtitoreje në Grykën e Shalës? 3. Riparimi i ujësjellësit, pasi nuk ka furnizim të rregullt me ujë? 4. Rregullimi i kanalizimit për shkak të problemeve ekzistuese? 5. Renovimi i dyshemesë së shkollës, pasi është vjetruar?	1. Kërkesa është pranuar, pasi që është paraparë rikonstruktimi i rrugës kryesore. 2. Kërkesa është pranuar, pasi që është paraparë ndërtimi i shtigjeve për ecje në Shalë. 3. Kërkesa është pranuar. Përmes kontratës së mirëmbajtjes do të intervenohet në riparimin e ujësjellësit. 4. Kërkesa është pranuar. Është paraparë zgjerimi dhe rregullimi i rrjetit të kanalizimit. 5. Kërkesa është pranuar pjesërisht. Do të shqyrtohet mundësia që, përmes kodit të donatorëve, të parashihet edhe renovimi i dyshemesë së shkollës.	F M T 1 15 16	28.08.2026 Shkolla fillore "Ibrahim Banushi" Shalë Ora 20:00




Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup " Qytetarët e Shalës".

Organizimi i dëgjimeve buxhetore për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, ka vazhduar me datën 08.09.2026 me anëtarët e Kuvendit, anëtarët e KPF-së, komitetit për komunitet, komitetet tjera, OJQ-të si, përfaqësueset e grupit të grave dhe kryetarët e këshillave të fshatrave. Kryesuesi i Kuvendit Komunal z. Daut Azemi, ka organizuar takim me përfaqësuesit institucionalë për planifikimin e buxhetit 2027-2029, ku ka marrë kërkesat dhe prioritetet për planifikimin e buxhetit komunal. Lista dhe procesverbal i takimit të kryesuesit me përfaqësuesit institucional gjenden në sektorin e Kuvendit Komunal.

Dëgjimi Buxhetor për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027-2029, me "Anëtarët e kuvendit, Anëtarët e KPF-së, komitetet tjera, OJQ-të, përfaqësueset e grupit të grave dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027-2029	- Zgjidhja e problemit me ujin e pijshëm? - Shtimi i numrit të kontejnerëve për mbeturina? - Ndarja e një shume për vizita studimore jashtë vendit për anëtarët e Kuvendit dhe Komitetin për Komunitete? - Asfaltimi i rrugicave të mbetura? - Rregullimi i ndriçimit publik dhe plotësimi i 5 shtyllave pa poça?	- Kërkesa është pranuar. Në planifikimin buxhetor për vitet 2027–2029 është paraparë investimi në sistemin e ujësjellësit në disa fshatra. - Kërkesa është pranuar pjesërisht. Do të shqyrtohet mundësia që, përmes kontratës së mirëmbajtjes, të parashihet edhe shtimi i numrit të kontejnerëve. - Kërkesa është pranuar pjesërisht. Do të shqyrtohet mundësia që, përmes mbështetjes së donatorëve, të realizohet një vizitë e tillë. - Kërkesa është pranuar. Në disa fshatra është paraparë asfaltimi i rrugicave të mbetura pa asfaltuar. Ndërsa rrugicat që kanë probleme pronësore nuk mund të përfshihen në projektet e asfaltimit. - Kërkesa është pranuar. Përmes kontratës së mirëmbajtjes do të bëhet rregullimi i ndriçuesve të dëmtuar.	F M T 6 19 25	08.09.2026 Salla e Kuvendi Komunal Ora 14:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Anëtarët e Kuvendit, anëtarët e KPF-së, komitetet tjera, OJQ-të, përfaqësueset e grupit të grave dhe kryetarët e këshillave të fshatrave".

Konkluzionet

Organizimi i dëgjimeve buxhetore të zhvilluara në kuadër të procesit të hartimit të Projekt-Buxhetit të Komunës së Lipjanit për periudhën 2027–2029 ka shërbyer si mekanizëm për evidentimin e drejtpërdrejtë të nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes këtyre konsultimeve, qytetarët kanë paraqitur kërkesa konkrete për projekte, për të cilat janë shqyrtuar mundësitë për përfshirjen e tyre në planifikimet buxhetore. Pas përfundimit të procesit të planifikimit, Projekt-Buxheti do t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit dhe më pas do të përcillet në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.


Kërkesat e paraqitura gjatë dëgjimeve kanë mbuluar fusha të ndryshme të interesit publik. Pjesa më e madhe e tyre lidhet me zhvillimin e infrastrukturës lokale, përfshirë asfaltimin dhe rikonstruktimin e rrugëve, ndërtimin e trotuareve, përmirësimin e ndriçimit publik, zgjerimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore. Janë paraqitur gjithashtu kërkesa për mbështetjen e sportit, aktiviteteve kulturore dhe organizatave joqeveritare.

Nga gjithsej 38 kërkesa të paraqitura, 31 janë pranuar plotësisht, që përbëjnë 81.58% të totalit. Gjashtë kërkesa ose 15.79%, janë pranuar pjesërisht, ndërsa një kërkesë ose 2.63%, nuk është pranuar. Kjo tregon se 97.37% e kërkesave kanë marrë përgjigje pozitive ose të pjesshme nga Komuna e Lipjanit. Për kërkesat e pranura pjesërisht janë paraparë alternativa për shqyrtimin e mundësive të financimit, përfshirë përdorimin e fondeve nga donatorët dhe kontratat ekzistuese të mirëmbajtjes. Kjo tregon angazhimin për t'u dhënë përgjigje kërkesave të qytetarëve dhe për të garantuar një proces transparent dhe të përgjegjshëm.

Ndër kërkesat e përfshira në planifikime janë investimet në rrugë dhe hapësira publike, ndriçimi publik, mirëmbajtja e parqeve dhe terreneve sportive, zgjerimi dhe rikonstruktimi i rrjeteve të kanalizimit dhe ujësjellësit, si dhe ndërhyrjet në objektet shkollore. Në planifikimet për periudhën 2027–2029 janë përfshirë edhe projekte të caktuara për mbështetjen e sportit dhe OJQ-ve, si dhe investime në pajisje dhe infrastrukturë arsimore.

Të dhënat e mbledhura nga dëgjimet buxhetore paraqesin një pasqyrë të prioriteteve të qytetarëve dhe ofrojnë bazë për orientimin e investimeve komunale gjatë viteve të ardhshme. Përfshirja e kërkesave konkrete nga komunitetet e ndryshme mundëson që planifikimi buxhetor të lidhet më drejtpërdrejt me nevojat e identifikuar në terren dhe me kapacitetet financiare të komunës.

Numri i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për planifikimin e Projekt-Buxhetit për vitet 2027–2029 ishte si vijon: 101 burra dhe 38 gra, me gjithsej 139 pjesëmarrës në tetë takimet e zhvilluara për planifikimin e Projekt-Buxhetit, si dhe në dy takime të organizuara nga sektori i Kuvendit. Listat e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore i janë bashkëngjitur këtij raporti.



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr. 28/14000 Lipjan, Kosovë